



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.935/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi, Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Bekim Murati nga Subjekti Politik Socjaldemokratska Unija, me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.935/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Bekim Murati nga Subjekti Politik Socjaldemokratska Unija, me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimin për Kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Socjaldemokratska Unija, në Komunën e Prizrenit, në Vendvotimet: 2040A/02D, BM120/002, BM120/003, BM220/001, BM220/002 dhe BM220/003.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.935/2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Bekim Murati nga Subjekti Politik Socjaldemokratska Unija, me seli në Prizren, me të cilën pretendon se në vendvotimin 2040A/02D ka dëshmi se e kanë votuar familjar të ngushtë ndërsa votat nuk i kanë dalë, gjithashtu ka pasur edhe parregullsi të tjera sa i përket bartjes së votave për subjektin Nova Demokratska Stranka.

Gjithashtu pretendon se familjarë nga Kroacia e kanë votuar ndërsa në votat e publikuara nga diaspora nuk i figuron asnjë votë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Bekim Murati nga Subjekti Politik Socjaldemokratika Unija, kërkon rinumërimin e votave në vendvotimet e lartë cekura, PZAP pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i paraqitur nga kandidati në fjalë për rinumërimin e votave për vendvotimet e lartë cekura është i bazuar .

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket vendvotimeve të vendosura si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, nga se rezulton se në Formularin e Rezultateve të Kandidateve në qendrat e votimit të apeluara kandidati për kuvend komunal Bekim Murati i ka 0 vota, ndërsa sipas deklaratës së apeluësit të bashkangjitur në apel e që ndërliidhen me këto VV, deklaroi se kanë votuar të gjithë anëtarët e familjes në VV 2040A/02D, kurse në votat nga diaspora, saktësisht vendvotimet BM120/002, BM120/003, BM220/001, BM220/002 dhe BM220/003 ka deklaruar se e kanë votuar familjar nga Kroacia mirëpo këto vota nuk rezultojnë të jenë në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, prandaj paneli konstaton se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar me deklaratatën e votueseve andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj ky panel, vlerëson se rinumërimi në këtë vendvotim e bënë procesin e rinumërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e rinumërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për ëmërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze, gjithashtu në mbështetje të nenit 117.4 dhe po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartë cekur duke vendosur si në dispozitivin të këtij vendimi.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.935/2021 më datën 06.11.2021.

Kryesues i Panelit
Ferki Xhaferi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118, par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.